



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM
RURAL,MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 12
nga mbledhja e mbajtur më **15.5.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Berat Luzha, Hestet Cakolli , Myrvete Pantina,
Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zef Morina dhe Zylfi Merxha.

Mungoi :

Ibrahim Selmanaj, Ali Lajçi dhe Selvie Halimi.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : Shefki Zeqiri dhe vëzhguesit e rregullt.

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Projektligji për ndryshimet në Ligjin për pyje 2003/3,
3. Projektligji për Ushqimin,

Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Lulzim Zeneli përshëndeti anëtarët e komisionit duke konstatuar miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Projektligji për ndryshimet në Ligjin për Pyje 2003/3

Lulzim Zeneli konstatoi prezencën e Shefki Zeqirit i cili kishte marr porosinë nga ministri i Bujqësisë për të njoftuar komisionin që MBPZHR nuk ka ndërruar raportin-qëndrimin lidhur me këtë projektligj duke propozuar që ajo të kalojë procedurën parlamentare deri në miratim.

Kryesuesi **Lulzim Zeneli** tha se ky dokument nuk do të mund të implementoi Ligjin për Pyje ashtu si duhet ngase problemet janë tepër shqetësuese me përmasa të mëdha. Kërkesa e këtij komisioni në seancën plenare të nesërme, sipas tij, do të ishte që ky projektligj të kthehet Qeverisë dhe të punohet shumë më seriozisht duke shqyrtuar edhe politikën rreth kësaj fushe : pse nuk po ndalet shkatërrimi i pyjeve.

Elheme Hetemi arsyetoi mendimin e kryesuesit duke shtuar se ligji i tanishëm është joefikas ngase komunat kanë qenë pa kompetenca, ndaj propozoi punë të përbashkët për ndryshime efikase. Ajo shtoi se propozimet në projektligj mund të shkaktojnë implikime buxhetore, sidoqoftë vetëm me roje nuk mbrohen pyjet, përfundoi ajo.

Berat Luzha fillimisht kërkoi që herave tjera ministri mos të dërgoi stafin civil në vend të stafit politik, gjë kjo që ka qenë rregull në këtë komision. Projektligji sipas tij duhet të tërhiqet ngase nuk përmirëson përmbajtjen rrënjësore të ligjit nga viti 2003, kështu ky ligj nuk mund të vazhdoi më ngase pylltaria është në gjendje katastrofave. Komunat nuk kanë qasje në APK, sidomos atje në Deçan, më në fund edhe pakoja e Ahtisarit obligon kalimin e kompetencave nëpër komuna, ndërsa zyrat ekzistuese të APK nëpër komuna janë themeluar në kundërshtim me ligjin.

Heset Cakolli duke u pajtuar me parafolësit tha se për seancën e nesërme duhet të ketë komisioni qëndrimin unik, çka nuk kundërshtoi **Myrvete Pantina** por ajo kërkoi mundësin e caktimit të afatit deri kur mund ta përmirësoi projektin Qeveria. Gjithashtu ajo pyeti se a mundet Qeveria me një vendim politik të ndërpres prerjen e pyjeve , në çka kryesuesi u ndërlidh me konstatimin se ekziston frika nga vazhdimi me avazin e vjetër të prerjes së pyjeve, por u pajtua që të bëhet apeli për ndërprerjen-ndalimin e çdo aktiviteti të prerjes së pyjeve. Këtyre mendimeve iu bashkëngjiti edhe **Kosara Nikoliq** duke i vërtetuar këto vërejtje personalisht , ngase ajo posedon pyje në pronën personale.

Zef Morina shfaqti brengën për tërheqjen e një projektligji pasi që është procedurë komplekse, ndaj pyeti mos është më mirë ti qaset komisioni rregullimit të tij. Konstatimi i tij ishte se mosardhja e ministrit sot do të thotë se nuk dëshirojnë të tërheqin projektin nga procedura parlamentare. Përndryshe ai njoftoi të pranishmit se në kohën kur është nxjerr ky ligj ka pas shumë të meta si e tillë, ngase ai ka qenë atëherë ministër dhe e ka të njoftun këtë fakt.. **Berat Luzha** reagoi se është e domosdoshme tërheqja e këtij projekti i cili asgjë nuk përmirëson, përndryshe ligji ekziston dhe është në fuqi.

Shefki Zeqiri reagoi se ligji në fuqi është duke u zbatuar edhe në nivel qendror dhe komunal por moszbatimi i tij rrjedhë nga dobësitë e Gjykatave, Policisë, qytetarët e pandërgjegjshëm etj , jo vetëm se ligji është i dobët.

Megjithate , **vazhdoi kryesuesi**, nëpër shumicën e komunave të Kosovës , përgjigja kryesore e zyrtarëve të APK është “nuk kemi çka me bo”, ndaj kjo është arsyeja kryesore e reagimit të nesërm të komisionit gjatë leximit të parë të këtij projektligji.

Në funksion të kësaj **Berat Luzha** kërkoi një takim me zyrtarët e MBPZHR gjatë javës së ardhshme, për çka do të diskutohet në mbledhjen e radhës (sugjerimi kryesuesi).

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Në seancën plenare të dt. 16.5.2008 kryetari i Komisionit të kërkoi në leximin e parë nga Kuvendi i Kosovës të tërhiqet projektligji për ndryshime të Ligjit për Pyje nr.2003/3 për shkak se nuk mundëson zbatimin e plotë të ligjit në fjalë dhe nuk mundëson ndërprerjen e dukurisë shqetësuese të shkatërrimit të pyjeve , sidomos me anë të prerjes së tyre.

2. Në ndërkohë Qeveria të angazhohet të mbuloi këtë zbrazëti ligjore me anë të një vendimi i cili do të ndaloj në tërë Kosovën ndërprerjen e shkatërrimit të pyjeve , përkatësisht ndërprerjen e prerjes së tyre.

Projektligji për Ushqimin

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e vërejtjeve nga legjislacioni i dytë lidhur me projektligjin e ushqimit duke miratuar amendamentet në mbështetje të sugjerimit nga Qeveria që Agjencioni i Ushqimit duhet të mbetet në kuadër të Qeverisë-Zyrës së Kryeministrit.

Komisioni gjithashtu u pajtua që në kuadër të emërimit të Agjencionit të mbetet fjala “Veterinarisë” sepse përndryshe pastaj duhet të formohet edhe Agjencioni për Veterinari. Fjala “mund” u vendos që të ndryshohet me “duhet” në tërë tekstin e projektligjit për shkak të karakterit obligativ që duhet të ketë ligji.

Disa ndryshime-amendamente janë nxjerr në funksion të përshtatjes së tyre emërimit të Agjencionit sipas propozimit nga Qeveria, dhe poashtu janë mbështetur disa vërejtje të komisionit të Shëndetësisë në legjislacionin e dytë.

Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

Rekomandimet lidhur me projektligjin e ushqimit të dërgohen në procedurën e mëtejme parlamentare-komisioneve kryesore, paraprakisht të kontrollohen edhe një herë nga kryetari i komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli